



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVO BAR ASSOCIATION

V. KD. Nr.15-2/2022

KOMISIONI DISIPLINOR I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga Arsim Billali Kryetar, Besian Syla anëtar dhe Fitim Shporta anëtar, me pjesëmarrjen e Vjollca Ajeti, Administratore në Zyrën Disiplinore në OAK - Procesmbajtëse, duke vendosur lidhur me Propozimin e Prokurorit Disiplinor me nr.15-5/2021 të datës 23.06.2022, ndaj të paraqiturit _____ avokat në _____ me adresën Rruga _____ nr. _____ në _____ konform nenit 16 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të OAK-së të datës 07.03.2020, pas zhvillimit të seancës së shqyrtimit fillestar më datën **07.07.2022**, merr këtë:

VENDIM

- I. **HEDHET** Propozimi i Prokurorit Disiplinor me nr.15-5/2021 të datës 23.06.2022
- II. **PUSHOHET** Procedura-Disiplinore ndaj avokati _____ nga _____
- III. **SHPENZIMET** e procedurës disiplinore bien në barrë të buxhetit të OAK-së

Arsyetim


Kolegji Disiplinor i OAK-së, pas pranimit të Propozimit nga Prokurori Disiplinor i OAK-së, e ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar më datë **07.07.2022**, në përbërje të plotë.

Kolegji Disiplinor i OAK-së në seancën e mbajtur me shqyrtim fillestar pasi bëri shqyrtimin dhe analizimin e shkresave të lëndës të bashkangjitura si në Propozimin e Prokurorit Disiplinor me nr.15-5/2021 të datës 23.06.2022, konform nenit 19 par. 1, pika 1.1 të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokat dhe Praktikantëvendosi që ndaj të paraqiturit av. _____ i, me adresë rruga _____ në _____, të pushohet procedura disiplinore, sipas Propozimit të ZPD-së, se në rastin konkret fjalia “Dega e Prishtinës nuk ka kryesi që moti” konsiderojmë se ky veprim i ndërmarrë nga i paraqituri nuk përbënë asnjë element të ndonjë shkelje disiplinore me arsyetimin se i njejtë ka shprehur mendimin dhe në vazhdimësi të kësaj fjale ka arsyetuar duke thënë se: “ për faktin se sekretari i saj z. _____ ka dhënë dorëheqje.....”. Është fakt i pakontestueshëm se z. _____ ka dhënë dorëheqje nga pozita e sekretarit të Degës Regjionale në Prishtinë, ndërsa sa i përket legjitimitetit të Degës Regjionale në Prishtinë nuk bie në domenin e Komisionit Disiplinor të vlerësojë rreth legjitimitetit por kjo është e drejtë ekzkluzive e organeve tjera të OAK-së.

Nga e cekura Komisioni disiplinor vendosi si ne dispozitiv te ketij vendimi.

Komisioni Disiplinor i Odës së Avokatëve të Kosovës
V.KD. Nr.15-2/2022 të dt: 07.07.2022

Procesmbajtësja:
Ma.sc.Vjollca Ajeti



Kryetar i Kolegjit Disiplinor:
Av. Arsim Billali



KËSHILLË JURIDIKE

Kundër këtij vendimi, palët kanë të drejtë të paraqesin ankesë në Komisionin e Ankesave të OAK-së, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimimit të vendimit. Ankesa i dërgohet Komisionit të Ankesave në OAK, përmes këtij Komisioni.